Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Ideal Partners shpk" të datës 06.11.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rruga A - Vazhdimi i rrugës A (pjesa Kalabri)" me nr. të prokurimit 616-26-7954-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Ideal Partners shpk" të datës 06.11.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rruga A - Vazhdimi i rrugës A (pjesa Kalabri)" me nr. të prokurimit 616-26-7954-5-1-1.

II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit.

III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Ideal Partners shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 06.11.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rruga A - Vazhdimi i rrugës A (pjesa Kalabri)" me nr. të prokurimit 616-26-7954-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

1. Kërkesat e Stafit Profesional (Neni 9.1 & 9.2)

• Pika 3 (Inxhinieri i Gjeodezisë): Kushti që inxhinieri të jetë "ekspert i certifikuar i GIS" është i panevojshëm dhe i paarsyeshëm për një projekt ekzekutiv të ndërtimit të ulët rrugor. Kjo certifikatë specifike nuk ndikon në cilësinë e matjeve standarde të trasesë.
• Pika 6 (Inxhinieri i Elektroteknikës): Kërkesa që të jetë "Auditor i Energjisë në Ndriçimin Publik" dhe të ketë menaxhuar projekt SMART është tejet specifike dhe eliminon shumicën e inxhinierëve me përvojë të përgjithshme në ndriçim publik.
• Pika 7 (Ekonomisti): Kërkesa për certifikim specifik në "ESRx" dhe "FPP" është tërësisht diskriminuese dhe e palidhur me menaxhimin financiar të pozicioneve të ndërtimit të një rruge prej 861 metrash

• Pika 1 - Buldozer (min. 14 ton - max. 16 ton):

Shkelja: Përcaktimi i një mase kaq të ngushtë (14-16t) për pozicionet e gërmimit dhe formësimit (Pozicioni 1.3 & 1.4) është eliminues. Çdo buldozer ekuivalent mbi 12 ton kryen të njëjtin funksion.
Kërkesa: Të ndryshohet në: "Buldozer mbi 12 ton" pa kufizim maksimal.
• Pika 2 & 3 - Ekskavatorë (26-30 ton) dhe (20-26 ton):
Shkelja: Ndarja artificiale në dy kategori të ngushta tonazhi për të njëjtin pozicion gërmimi (Pozicioni 1.3.1).
Kërkesa: Të fshihet ndarja dhe të kërkohet: "Ekskavator për gërmim mbi 20 ton – 2 copë".
• Pika 4 - Ekskavator me zinxhir, pllug dhe riper (23 ton - max. 25 ton):
Shkelja: Kushtëzimi i peshës ekzakte 23-25 ton për thyerjen e materialeve (Pozicioni 1.2) është joproporcionale. Funksioni varet nga riperi dhe fuqia hidraulike, jo nga kjo fashë e ngushtë peshe.
Kërkesa: Të ndryshohet në: "Ekskavator me riper mbi 20 ton".
• Pika 5 & 6 - Ekskavatorë (5-8 ton) dhe (4-5 ton me zinxhir gome):
Shkelja: Këto dy pika mbivendosen për të njëjtat punë të hapjes së kanaleve të ngushta të ujësjellësit dhe ndriçimit (Pozicioni 1.0).
Kërkesa: Të fshihet pika 6 dhe pika 5 të ndryshohet në: "Ekskavator i vogël/Miniekskavator mbi 3.5 ton – 2 copë".
• Pika 7 - Sharrë prerëse hidraulike që montohet në ekskavator (max. 60 kg):
Shkelja: Për pozicionin 1.2.10 (prerja e asfaltit), prerja mund të bëhet me çdo sharrë standarde manuale me motor. Kushtëzimi që të jetë hidraulike e montuar në ekskavator është tërësisht diskriminues.
Kërkesa: Të largohet plotësisht kjo kërkesë ose të shtohet "apo ekuivalente manuale".
• Pika 9 & 10 - Ngarkues (20-24 ton) dhe (12-16 ton):
Shkelja: Paramasa nuk specifikon asnjë pozicion që kërkon dy ngarkues të ndryshëm me kategori kaq të afërta peshash.
Kërkesa: Të fshihet pika 10 dhe të kërkohet: "Ngarkues (Loader) mbi 12 ton – 1 copë".
• Pika 11 & 12 - Ngarkues me fshesë (6.5-8.5 ton) dhe Ngarkues me fshesë e pirun (5-6 ton):
Shkelja: Mbivendosje e pastër për pozicionet e pastrimit (1.1.2) dhe bartjes së gurëve (1.4.14). Ndarja bëhet vetëm për të eliminuar kompanitë që kanë një makineri universale kombinuese.
Kërkesa: Të fshihet pika 11 dhe pika 12 të ndryshohet në: "Ngarkues kombinues (fshesë/pirun) – 1 copë".
• Pika 13 - Makinë për shtrimin e Bankinave dhe Rigollave me GPS dhe nivelizues automatik:
Shkelja: Për pozicionin 1.3.3 (shtrimi i bankinave 15cm), ky kushtëzim me sistem GPS të integruar në makineri është jashtëzakonisht diskriminues. Kjo punë realizohet me grejder standard dhe kontroll gjeodezik.
Kërkesa: Të largohet plotësisht kërkesa për GPS dhe nivelizues automatik në makineri.
• Pika 14 - Kamion me rimorkio për transport të makinerisë (min. 38 ton):
Shkelja: Ky është shërbim logistik i jashtëm transporti që nuk përbën kapacitet teknik të drejtpërdrejtë në ndërtimin e rrugës.
Kërkesa: Të largohet si kriter i detyrueshëm për pronësi/qira specifike të lidhur me projektin.
• Pika 15 & 16 - Makinë për sheshim (4-6 ton) dhe Grejder mbi 16 ton:

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Shkelja: Grejderi mbulon të gjitha pozicionet e nivelizimit (1.3.2, 1.4.5, 1.4.6). Makina 4-6 ton është kërkesë e paarsyeshme dhe limitimi i grejderit "mbi 16 ton" eliminon grejderët standardë më të lehtë.
Kërkesa: Të fshihet pika 15 dhe pika 16 të ndryshohet në: "Grejder mbi 12 ton".

- Pika 17 - Damper mbi 3 ton:

Shkelja: Funksioni i bartjes së dheut mbulohet plotësisht nga kamionët ose kamionetat kiper (Pika 46), duke e bërë këtë kërkesë artificiale.
Kërkesa: Të largohet plotësisht.

- Pika 18 - Cilindër Teledirigjues (max. 2 ton):

Shkelja: Ngjeshja e kanaleve (Pozicioni 1.0) mund të bëhet me çdo cilindër standard të vogël ose vibrues manual, pa u kushtëzuar me kontroll teledirigjues.
Kërkesa: Të ndryshohet në: "Cilindër i vogël për kanale ose pllakë vibruese" pa kushtin teledirigjues.

- Pika 19 & 20 - Cilindra me vemza (21.5-22.5 ton) dhe (15.5-17.5 ton):

Shkelja: Ndërtimi i dy kategorive të veçanta me vemza për pozicionin 1.3.2 është krejtësisht artificial. Cilindri matet me forcën e vibrimit, jo me këtë fashë të ngushtë peshe.
Kërkesa: Të grupohen në: "Cilindër me vemza (padfoot) mbi 15 ton – 1 copë".

- Pika 21 & 22 - Cilindër vibrues (17-19 ton) caps dhe (10-12 ton):

Shkelja: Për pozicionet e ngjeshjes së tamponit (1.4.5, 1.4.6, 1.4.8), një cilindër standard 12-tonësh është plotësisht i mjaftueshëm. Ndarja në fasha tonazhi është kufizuese.
Kërkesa: Të ndryshohet në: "Cilindër vibrues hekur-hekur mbi 10 ton – 2 copë".

- Pika 23 & 24 - Cilindër jo vibrues (11-13 ton) dhe (17-19 ton):

Shkelja: Funksioni "jo-vibrues" për pozicionin 1.4.8 realizohet me çdo cilindër standard thjesht duke fikur opsionin e vibrimit. Kërkesa për makineri të veçantë statike është teknikisht e pabazuar.
Kërkesa: Të largohen të dy këto pika si makineri të veçanta, pasi ky funksion mbulohet nga pikat 21 dhe 22.

- Pika 26 - Gjysmërimorkio për pastrim me dy pompa min. 220 bar:

Shkelja: Specifikim jashtëzakonisht i ngushtë për pozicionin 1.1.2. Pastrimi i rrugës bëhet me cisterna standarde uji ose fshesa mekanike.
Kërkesa: Të ndryshohet në: "Cisternë uji ose pajisje për pastrimin e rrugës".

- Pika 27 - Gjysmërimorkio kiper me kran min. 6m (max. 1.2 ton):

Shkelja: Për montimin e shtyllave (Pozicioni 1.6), kërkesa që krani të jetë patjetër i montuar në një "gjysmërimorkio kiper 6m" është e paligjshme. Mund të përdoret çdo kamion standard me kran (autovinç).
Kërkesa: Të ndryshohet në: "Kamion me kran (autovinç) ose ekuivalent".

- Pika 28 - Cisternë (Autobotë) për karburante:

Shkelja: Ky është funksion logjistik i brendshëm. Furnizimi mund të bëhet nga kompanitë e licencuara të derivateve në terren.
Kërkesa: Të largohet plotësisht si kriter kualifikues.

- Pika 29 & 31 - Kamion me fshesë dhe spërkatës dhe Makinë për Bitolit (400-600 kg):

Shkelja: Këto pika mbivendosen plotësisht për pozicionet e spërkatjes me emulsion (1.4.9, 1.4.12).
Kërkesa: Të ndryshohet në: "Pajisje/Kamion për shpërndarjen e emulsionit/bitumit – 1 copë".

- Pika 33 - Gërryese e asfaltit (6-8 ton):

Shkelja: Pasi në pikën 32 kërkohet frezë 16-18 ton, kërkesa për një frezë të dytë të vogël për vetëm 600 m² gërryerje (Pozicioni 1.2.11) është e tepërt.
Kërkesa: Të largohet pika 33 dhe puna të lejohet të kryhet me frezën e pikës 32.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

- Pika 34, 35, 36, 37 - Katër lloje Finisherash për shtrirjen e asfaltit:

Shkelja: Kërkesa për katër finishera të ndryshëm me katër fasha të ngushta peshash është e paarsyeshme për një segment nën 1 km. Teknikisht mjafton një finisher për rrugën dhe një për shtigjet e biçikletave.

Kërkesa: Të ndryshohet në: "Finisher për shtrirjen e asfaltit – 2 copë" pa kufizime të ngushta tonazhi.

- Pika 38, 39, 40, 41, 42 - Katër kategori Cilindrash për asfalt (Gjithsej 6 copë):

Shkelja: Kërkesa për 6 cilindra asfalti të ndarë në fasha kaq të ngushta (7.5-8.5t hekur-hekur, 7.5-8.5t gomë-hekur, 4-5t, 3-4t) është joproporcionale.

Kërkesa: Të ndryshohet në: "Cilindër hekur-hekur për asfalt – 2 copë" dhe "Cilindër me goma për asfalt – 1 copë" pa specifika të ngushta peshe.

- Pika 43 - Cilindër-Rul me shtytës me xhemba (400-600 kg):

Shkelja: Mbivendoset me pajisjen nr. 42 dhe funksioni mbulohet plotësisht nga pllakat vibruese standarde.

Kërkesa: Të largohet plotësisht.

- Pika 44 - Kovë për përzierjen e betonit (min. 300kg - max. 600kg):

Shkelja: Kërkesa për të përzier beton me kovë në ekskavator është absurde, pasi paramasa kërkon që betoni të sillet i gatshëm nga baza e betonit (Pika 5 e kritereve dhe Pozicioni 2.1).

Kërkesa: Të largohet plotësisht.

- Pika 45 - Kamionetë Doublekabine (bartëse 1.2t - 1.4t) - 3 copë:

Shkelja: Transporti i personelit mund të bëhet me çdo lloj automjeti (furgon, veturë). Kushtëzimi i këtij modeli dhe peshe është i pabazuar.

Kërkesa: Të ndryshohet në: "Automjete për transport të personelit/veglave – 3 copë".

- Pika 47 - GPS për matje gjeodezike - 2 copë:

Shkelja: Kushtëzimi i ekzekutimit vetëm me 2 copë GPS është kufizues, pasi pozicionet e kanalizimit dhe trasesë (Pozicioni 1.1.1) kërkojnë Takometra Elektronikë (Total Station) për precizitet milimetrik.

Kërkesa: Të ndryshohet në: "Pajisje gjeodezike (GPS ose Total Station/TCR) – 2 copë".

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur se parashtruesi ka prezantuar argumente pjesërisht të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Rrjedhimisht AK në koordinim me njësinë kërkuese do të rishqyrtoj edhe njëherë kërkesat e DT me qëllim të harmonizimit të plotë me LPP dhe RRPP në fuqi.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik"*.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.11.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net